



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.389/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët– Skender Çoçaj kryesues, Bujar Muzaqi dhe Kymete Kicaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Avni Gashi, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komuna Istog, nga radhët e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Istog, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, Nr.01/3093-2025, të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për anëtarë të kuvendit komunal, për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 05.11.2025, merr këtë,

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ankesa ZL.Anr.389/2025, e datës 04.11.2025, e parashtruar Avni Gashi, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komuna Istog, nga radhët e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Istog, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, Nr.01/3093-2025, të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për anëtarë të kuvendit komunal, për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura me datën 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Më datë 04.11.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën ZL.Anr.389/2025, nga Avni Gashi kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Istogut, nga radhët e Subjektit Politik AAK me seli në Prishtinë, dega në Istog, i cili pretendon se në disa vendvotime janë bërë shkelje nga komisionarët e vendvotimit, përkatësisht në këto vendvotimet: SH.F.M.U “Hysni Zajmi” në Vrellë, VV 0606/03, VV 0606/04 dhe VV 0606/05, si dhe në VV 0602, dhe SH.F.M.U “Trepça” në Banjë të Pejës, VV 0602/02, VV 0602/03, VV 0602/05, VV 0602/06, VV 0602/07 si dhe votat me postë.

Sipas parashtruesit të ankesës në rezultatet përfundimtare për asamble komunale në Istog, kandidati nga radhët e subjektit politik AAK, me numër rendor 5, rezultojnë të ketë marrë 97 vota. Ndërsa sipas gjendjes faktike që është paraqitur në rezultatet e shpallura nga KQZ, si rezultate përfundimtare për asamble komunale në Istog, rezultojnë që në disa qendra votimi dhe vendvotime, i njëjti ka më pak vota edhe pse votuesit e tij, kanë deklaruar me shkrim që kanë votuar në këto vendvotime dhe se në bazë të deklaratave të tyre, numri i votave do të duhej të ishte më i madh.

Në Qendrën e votimit Slikolla Fillore "Hysni Zajmi" në Vrellë: Vendvotimi 0606/03 sipas rezultateve të KQZ janë të publikuara gjithsejtë 21 vota, kurse i njëjti posedon 26 deklarata të votuesve të cilët pohojnë se kanë votuar numrin 5. Po ashtu në Vendvotimin 0606/04, sipas rezultateve të KQZ janë të publikuara gjithsejtë 10 vota, kurse i njëjti posedon gjithsej 18 deklarata të votuesve, Vendvotimi 0606/05, sipas rezultateve të KQZ janë të publikuara gjithsejtë 44 vota, ndërsa deklarata e komisionerit të AAK-së Sadeta Vuthaj dhe deklarata nga Vëzhguesi i LDK-se Hamdi Zeqiraj, i njëjti pretendon se ka marrë 50 vota.

Në Qendrën e votimit 0602, SH.F.M.U "Trepça" Banjë e Pejës, në Vendvotimin 0602/02, sipas rezultateve të KQZ janë të publikuara 0 vota, kurse sipas deklaratës në këtë vendvotim duhet të ketë 1 votë. Në Vendvotimin 0602/03, sipas rezultateve të KQZ janë të publikuara gjithsejtë 0 (zero) vota, kurse sipas deklaratave duhet ti ketë 2 vota. Në vendvotimin 0602/05, sipas rezultateve të KQZ janë të publikuara gjithsejtë 6 vota, kurse sipas deklaratave duhet të ketë 7 vota. Në vendvotimin 0602/06, sipas rezultateve të KQZ, janë të publikuara gjithsejtë 3 vota, kurse i njëjti duhet ti ketë 6 vota. Në vendvotimin 0602/07, sipas rezultateve të KQZ, janë të publikuar gjithsejtë 2 vota, kurse i njëjti duhet ti ketë 3 vota.

Më tej në ankesë pretendohet se nga votimi me postë sipas rezultateve nga KQZ, janë publikuar gjithsejtë 14 vota, kurse sipas dëshmisë së familjarëve dhe miqve i njëjti ka gjithsejtë 21 vota në total: 9 familjar/miq nga Gjermania, 6 familjar/miq nga Zvicra, 5 familjar/miq nga Austria, 1 mik nga Brukseli.

Si provë në ankesë ka bashkangjitur deklarata të votuesve dhe komisionerëve, dhe kërkon nga PZAP-i, urdhëroj KQZ, që të bëj rinumërimin e votave.

Në përgjigjen në ankesë KQZ-ja, sqaron se bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/ L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025, NI-.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN.

Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund të korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN).

Andaj, bazuar në Rregullën Zgjedhore Nr.13/2024 Rezultatet e Zgjedhore nenin 9 paragrafi 1 thekson se: Në rast të mospërputhjes së rezultateve, KQZ-ja mund të urdhëroj rinumërimin e votave të cilit do VV, ose edhe përsëritjen e votimit në një VV apo QV.

KQZ, gjithashtu ju njoftoj se, procesi i numërimit të votave në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) është zhvilluar në përputhje me Rregulloren Zgjedhore Nr. 14/2024, Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) ku ekipet e numërimit kanë bërë numërimin e votave të kandidatëve në transparencë të plotë, ku fletëvotimi është prezantuar në ekran dhe është parë nga vëzhguesit e akredituar.

Më tej në përgjigje theksohet se më datën 03.09.2025, KQZ ka miratuar Procedurën Standarde të Veprimit për Votimin Jashtë Kosovës dhe Vlerësimin e Pakove me Fletëvotime. Në faqen 14 të kësaj procedure shpjegohet mënyra e vlerësimit të pakove me fletëvotime, ndërsa pas përfundimit të procesit të verifikimit të zarfeve me fletëvotime, DSHV dorëzon në QNR listën e votuesve të cilët kanë votuar përmes postës dhe zarfet me fletëvotime të ndara në kuti sipas komunave të votuesve. (Shih të bashkangjitur Procedurën Standarde të Veprimit për Votimin Jashtë Kosovës dhe Vlerësimin e Pakove me Fletëvotime),

Bazuar në nenin 17 të Rregullores Zgjedhore nr. 17/2024 për Regjistrimin dhe Votimin Jashtë Kosovës parashihet numërimi i fletëvotimeve të dërguara me postë, sipas të cilës: 1 7, Fletëvotimet që janë dërguar përmes postës dhe fletëvotimet që janë hedhur në kutitë e votimit nga procesi i votimit në përfaqësinë diplomatike, numërohen në QNR.

Ndërsa në nenin 20 të Rregullores Zgjedhore nr.14/2024 për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, parashihet procedura e numërimit të fletëvotimeve në QNR, përkatësisht, në paragrafin 9 të nenit 20 parashihet se: Zarfet e votimit me postë hapen dhe numërohen pas përfundimit të krahasimit të listave votuese të përcaktuara në nenin 18 të kësaj rregullore si dhe pas përfundimit të numërimit të votave në përfaqësi diplomatike,

Pala ankuese, ndër të tjera, ka pretenduar se disa nga familjarët kanë votuar për të mirëpo, sipas tij mungojnë votat e tyre. Ky pretendim nuk mund të vërtetohet, pasi që vota është e fshehtë dhe, në përputhje me parimet e fshehtësisë dhe lirisë së votës, dhe po ashtu në fletëvotim nuk mund të identifikohet emri i votuesit.

Sa i përket pretendimeve të palëve ankuese i cili mbështetet në pritshmërinë dhe deklaratimet e personave, dhe familjareve të tij, duhet theksuar se, në kuptim të nenit 4 paragrafi 1,3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara. Publikimi i votës cenon këtë parim dhe shpërfaq vullnetin e votuesit.

Parashtruesi i ankesës, nuk ka ofruar dëshmi të çarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LPZ-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, dhe pretendimet e ankuesit nuk mbështeten në asnjë provë konkrete por janë supozime sepse pritjet e ankuesit për të marr më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara.

Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LQP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se pala ankuese, po ashtu nuk ka bashkëngjitur prova relevante, që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet e saj. Pra, nuk ka bashkëngjitur libër të votimit në vendvotim dhe QKN, formularë, ose prova të tjera që do të mund të mbështesnin pretendimet e saj.

KQZ, ju njofton se i gjithë materiali zgjedhor, (duke përfshirë kamerat e sigurisë, Librat e Votimit dhe Formularët) gjenden në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve -QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet drejtësisë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës konstaton se:

Ankesa është e pabazuar

Pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe përgjigjes në ankesë të KQZ-së, Paneli vlerësoj se pretendimet në ankesën e parashtruar nga Avni Gashi, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Istog, nga radhët e Subjektit Politik AAK, të paraqitur kundër shpalljes së rezultateve përfundimtare të publikuara nga KQZ-së, janë të pabazuara.

Sa i përket pretendimeve të palës ankuese që mbështeten në deklaratat e disa personave – votuesve, të identifikuar me emër dhe mbiemër, numër personal, nënshkrimin e tyre si dhe numër të telefonit të tyre, sipas vlerësimit të panelit është e pamjaftueshme si provë e vetme të vërtetoj pretendimin e tij për parregullsi, nga se deklaratat e disa emrave të personave të ndryshëm si votues të mundshëm të kandidatit në fjalë, nuk mund të merret si dëshmi e vlefshme për të mbështetur pohimet e ankuesit për parregullsi në lidhje me shpalljen e rezultateve përfundimtare,

dëshmia si e tillë nuk e përmbushë as kushtin formal dhe as atë përmbajtësor të konsiderohet provë bindëse për procedim dhe hetim të mëtutjeshëm apo për hapjen e kutive të votimit.

Po ashtu është e pa kontestuar se bazuar në nenin 4 paragrafi 1.3 të LZP, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara, gjer sa shpërfaqja e vullnetit të votuesve në parim cenon fshehtësinë të votës.

Paneli vlerëson se deklaratat e votuesve të cilët pretendojnë se kanë votuar një kandidat të caktuar nuk mund të merren si prova të bazuara për faktin se nuk mund të vërtetohet në asnjë formë se votuesit përkatës të kenë votuar për subjektin e caktuar dhe kandidatin e caktuar për shkak se fletëvotimi nuk mund të identifikohet me emrin e votuesit.

Andaj Paneli vlerësoi se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe të pa bazuara dhe si të tilla i refuzoj. Kështu që bazuar në të lartcekurat konkludohet se nga veprimet e përshkruara në ankesë, parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetojë se ka pasur veprime që janë shkelur dispozitat ligjore të Ligjit për Zgjedhje apo të Rregullave Zgjedhore të KQZ-së.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nën përcaktohet se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar në nenin 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nëni 9 paragrafi 5.17, të Rregullore nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, dhe paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.389/2025 më datën 05.11.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.